



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 3939 prot.

Berat , më 28.07. 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, “ Mbi përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta për Znj.Nexhmije Sadiku, Z,Ajet Shahinaj, Z.Shefqet Boboçi ”.

KRYETARI

Ervin Demo

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtori Juridik

Konceptoi:

Piro Xheblati: Drejtori i Komanduar i Shërbimit Social

Datë: _____

Materialet për Znj.Nexhmije Sadiku, Z,Ajet Shahinaj, Z.Shefqet Boboçi .

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit për përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta: 1 (për të tre rastet).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues mbi përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta : 2 (për të tre rastet).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE NË RASTE TË VEÇANTA
Z.SHEFQET BOBOÇI**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesën e bërë nga Z. Shefqet Boboçi me Nr.3200 Prot, datë 17.06.2021, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c ; ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

JU RELATOJ:

Të nderuar këshilltarë!

Familja Boboçi përbëhet nga 2 (dy) anëtarë, Z.Shefqet dhe Znj.Nevreze. Familja jeton në Lagjjen nr.1, “Barrikad”. Prej disa muajsh Znj. Nevreze Boboçi është diagnostikuar me CA Polmonar (tumor në mushkri terminal). Të ardhurat që kjo familje ka, vijnë nga pensioni i dy bashkëshortëve. Familja Boboçi jeton vetëm me pensionet të cilët nuk arrijnë të plotësojnë nevojat bazë, pasi sëmundjet kronike si pasojë e moshës kërkojnë medikamente të kushtueshme dhe dy të moshuarit nuk arrijnë të përballohen. Familja jeton në një pallat ekzistues pranë Lagjjes nr.1 “Barrikad” të tipologjisë 1+1 në kushte normale.

Duke mos mjaftuar problemet e mësipërme, moshës së madhe të dy anëtarëve, në vitin 2021 Znj. Nevreze diagnostikohet me sëmundje tumoriale terminale, të tipit CA Polmonar në stad të agravuar. Sëmundja ka përparuar vullshëm dhe mjekët kanë bërë ndërhyrje kirurgjikale, duke hequr 80 % të mushkrisë pasi i rrezikohet jeta. Pas operacionit Znj. Nevreze duhet të ndjekë terapitë të cilat kanë kosto tepër të larta dhe të pa përballueshme nga familja.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Duke vlerësuar situatën social-ekonomike, dokumentacionin e paraqitur dhe gjithë dinamikën e problematikave që shfaq kjo familje, Drejtoria e Shërbimit Social propozon të mbështesë Z. Shefqet Boboçi në shumën 20.000 (njëzetë mijë) lekë për kurimin e nevojshëm të Znj. Nevreze.

Bashkëngjitur relacionit keni dokumentacionin si: kërkesë, çertifikatë familjare, kartë identiteti, analiza mjekësore, vlerësimin social-ekonomik, vërtetim pensioni.

DREJTORI I KOMANDUAR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ / ____ /2021

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE NË RASTE TË VEÇANTA
Z.SHEFQET BOBOÇI**

Komisioni i Ekonomisë, Taksave, DSHS në mbledhjen e datës ____ . ____ .2021, në mbështetje në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c; ligjin 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpezimeve në raste të veçanta për shtetasin Shefqet Boboçi në shumën 20.000 (njëzet mijë) lekë.
2. Shuma prej 20.000 (njëzetë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2021.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE NË RASTE TË VEÇANTA
Z.AJET SHAHINAJ**

Drejtorja e Shërbimit Social dhe Drejtorja e Financës, bazuar në kërkesen e bërë nga Z. Ajet Shahinaj me Nr.384 Prot, datë 21.04.2021, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c ; ligjin 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

JU RELATOJ:

Të nderuar keshilltarë!

Familja Shahinaj përbëhet nga 2 (dy) anëtarë, Z. Ajet dhe Znj. Alije. Familja jeton në Lagjien nr.1, “Çlirim”. Prej disa vitesh anëtarët madhorë të kësaj familje janë të papunë. Të vetmet të ardhura që ka kjo familje vijnë nga pagesa e invaliditetit që përfiton kryefamiljari dhe ndihma ekonomike. Z. Ajet për më shumë se 15 vite trajtohet me status invalidi. Kjo situatë e veshtirësoi së tepërmi gjendjen social-ekonomike të kësaj familje ku hasin vështirësi në sigurimin e nevojave bazë të jetesës. Duke mos mjaftuar problemet e mësipërme, Z. Ajet në vitin 2020 diagnostikohet me sëmundje Nefropatia Diabetike (veshka preket për shkak të diabetit) kjo sëmundje ka avancuar në stadin e 4 duke i shfaqur dhe sëmundjen e anemisë sekondare. Nga sa më sipër z. Ajet duhet të ndjek dializën. Papunësia ndër vite, gjendja e vështirë ekonomike dhe sëmundjet që e kanë shoqëruar këtë familje e kanë paralizuar totalisht mundësinë për tu kuruar. Familja Shahinaj jeton në një banesë të tipologjisë 1+1 në kushtet normale jetese e amortizuar. Duke vlerësuar situatën social-ekonomike, dokumentacionin e paraqitur dhe gjithë dinamikën e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

problematikave që shfaq kjo familje, Drejtoria e Shërbimit Social propozon të mbështesë Z. Ajet Shahinaj në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë për kurimin e nevojshëm të Z. Ajet.

Bashkëngjitur relacionit kenë dokumentacionin si: kërkesë, çertifikatë familjare, kartë identiteti, analiza mjekësore, fletë përmbledhje e daljes, epikrizë dalje, fletë drejtimi për KEMP, vërtetimin e invaliditetit/ndihmës ekonomike, analiza të ndryshme mjekësore.

DREJTORI I KOMANDUAR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ / ____ /2021

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE NË RASTE TË VEÇANTA
Z.AJET SHAHINAJ**

Komisioni i Ekonomisë, Taksave, DSHS në mbledhjen e datës ____ . ____ .2021, në mbështetje në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c; ligjin 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë ”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Per miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpezimeve në raste të veçanta për shtetasin Ajet Shahinaj në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.
2. Shuma prej 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2021.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 3939 prot.

Berat , më 28.07. 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, “ Mbi përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta për Znj.Nexhmije Sadiku, Z,Ajet Shahinaj, Z.Shefqet Boboçi ”.

KRYETARI

Ervin Demo

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtori Juridik

Konceptoi:

Piro Xheblati: Drejtori i Komanduar i Shërbimit Social

Datë: _____

Materialet për Znj.Nexhmije Sadiku, Z,Ajet Shahinaj, Z.Shefqet Boboçi .

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit për përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta: 1 (për të tre rastet).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues mbi përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta : 2 (për të tre rastet).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 3939 prot.

Berat , më 28.07. 2021

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Z. Ervin Ceca

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK BERAT

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues, “ Mbi përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta për Znj.Nexhmije Sadiku, Z,Ajet Shahinaj, Z.Shefqet Boboçi ”.

KRYETARI

Ervin Demo

Miratoi:

Petro Sinjari: Drejtori Juridik

Konceptoi:

Piro Xheblati: Drejtori i Komanduar i Shërbimit Social

Datë: _____

Materialet për Znj.Nexhmije Sadiku, Z,Ajet Shahinaj, Z.Shefqet Boboçi .

Nr. i faqeve A4 të projektvendimit për përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta: 1 (për të tre rastet).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues mbi përdorimin e fondit të shërbimit social, mbështetje financiare për përballimin e shpenzimeve të varrimit në rast fatkeqësie si dhe raste të veçanta : 2 (për të tre rastet).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL**

RELACION

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË RAST
FATKEQËSIE
ZNJ.NEXHMIJE SADIKU**

Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës, bazuar në kërkesen e bërë nga Znj. Nexhmije Sadiku me Nr.508 Prot, datë 27.05.2021, mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c ; ligjin 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

JU RELATOJ:

Të nderuar këshilltarë!

Familja Sadiku është një familje shumë e varfër, me shumë probleme të mëdha social-ekonomike. Z.Hajri Sadiku, kryefamiljari, për një periudhë të shkurtër gjatë vitit 2020 u trajtua me ndihmë ekonomike. Më pas familja skualifikohet nga ndihma ekonomike pasi djali i familjes Z.Mariglen Sadiku fillon punë në një fason për një periudhë 2-3 mujore. Aktualisht Znj. Nexhije jeton në një banesë të rrënuar në Lagjien nr.3, “Donika Kastrioti” në kushte ekstreme, jashtë çdo standardi jetik. Z.Hajri para se të ndërronte jetë siguronte të ardhurat duke mbledhur hekur në zonat rurale dhe magazina të rrënuara. Theksoj se përveç varfërisë ekstreme që i kishte kapluar, çifti vuante nga pamundësia totale për të siguruar nevojat bazë si dhe pamundësia për të shlyer detyrimet bankare. Me vdekjen e Z.Hajri problemet e kësaj familje janë shtuar së tepërmi pasi Znj. Nexhmije nuk ka asnjë të ardhur (kjo e verifikuar edhe në sistemin e-albania). Ajo nuk ka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

asnjë mbështetje pasi dhe fëmijët e larguar nga kjo banesë jetojnë në varfëri dhe pamundësi për ta mbështetur. Nisur nga sa më sipër, duke parë dhe njohur nga afër situatën e familjes Sadiku si dhe në bazë të verifikimeve të bëra në banesë, administrimit të dokumentacionit, kërkesës së paraqitur nga Znj. Nexhmije Sadiku, Drejtoria e Shërbimit Social konkludon se familja Sadiku e ka të pamundur përballimin e shpenzimeve të varrimit pasi nuk kanë asnjë të ardhur. Drejtoria e Shërbimit Social propozon të mbështesë Znj. Nexhmije Sadiku në shumën 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë për përballimin e shpenzimeve të varrimit.

Bashkëngjitur relacionit keni dokumentacionin si : kërkesë, çertifikatë vdekje/aktuale, vërtetimin nga ndihma ekonomike, fotokopje e kartës së identiteti, faturën e funeralit, relacionin social-ekonomik, foto të banesës.

DREJTORI I KOMANDUAR I SHËRBIMIT SOCIAL

Piro Xheblati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK**

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____ datë ____ / ____ /2021

**MBI PËRDORIMIN E FONDIT TË SHËRBIMIT SOCIAL, MBËSHTETJE
FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË VARRIMIT NË RAST
FATKEQËSIE
ZNJ.NEXHMIJE SQADIKU**

Komisioni i Ekonomisë, Taksave, DSHS në mbledhjen e datës ____ . ____ .2021, në mbështetje në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8, neni 24, /1, neni 40/6, neni 54, neni 64/c ; ligjin 68/2017 date 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4; ligjin nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë ”, VKB nr.81 datë 29.12.2020 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për përballimin e shpezimeve të varrimit në rast fatkeqësie (vdekje) për shtetasen Nexhmije Sadiku në shumën 25.000 (njëzet e pesë mijë) lekë.
2. Shuma prej 25.000 (njëzet e pesëmijë) lekë do të përballohet nga buxheti i Drejtorisë së Shërbimit Social për vitin 2021.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Shërbimit Social.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Ervin Ceca